

I nderuari z. Melani  
Të nderuar profesorë,  
Të nderuar studentë,  
Të nderuar pjesëmarrës,  
Zonja dhe zotërinj

Fillimisht më lejoni të uroj dhe falënderoj Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për organizimin e programit të trajnimit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar, dhe për ftesën e dërguar në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në këtë program.

Duke qenë se sot, në tregun e Kosovës ekziston numër jo i mjaftueshëm i Aktuarëve, dhe mungesës së aktuarit në BQK, pjesëmarrja dhe përfundimi me sukses i këtij programi të ndonjë nga stafi i BQK-së ka qenë shumë e rëndësishme.

Para së gjithash duke qenë një aktuar profesionist është shumë e rëndësishme jo vetëm për ju, por në çdo situatë të qenit profesionist gjatë kryerjes së detyrave është e rëndësishme për shkak se ju bëni atë që është e drejtë për institucionin që ju përfaqësoni.

Të qenit aktuar do të thotë të kesh pasion për matematikën, probabilitetin, ekonominë dhe menaxhimin e rrezikut, diçka që sektorit tonë i mungon, në këtë kohë, në të cilën duhet të jemi të shpejtë dhe të saktë. Unë jam shumë i sigurtë që ju të gjithë e keni këtë talent.

Të qenit aktuar do të thotë respekt nga bashkëpunëtorët tuaj, por nënkupton edhe përgjegjësi, e cila vjen nga të qenit i respektuar.

Të qenit aktuar do të thotë mbrojtje e policëmbajtësve, mbajtje e premtimeve ndaj kompanisë tuaj dhe t'iu përmbahesh rregullave të vëna nga Rregullatori, por nganjëherë do të thotë edhe sqarimin e gjërave të vështira menaxhmentit, policëmbajtësve dhe rregullatorit.

Të qenit Aktuar do të thotë që ju veçse i posedoni njohuritë teknike, keni gjykimin e drejtë për detyrat për të cilat jeni caktuar t'i bëni, por gjithashtu keni njohurinë dhe jeni të vetëdijshëm se si funksionon biznesi.

Të qenit aktuar do të thotë që do jeni fleksibël dhe të gjithanshëm në detyrat tuaja, me të gjithë akterët në kompanitë tuaja, duke filluar nga marketingu, shitja, menaxhimi i rrezikut, marrja në sigurim, investimet etj. po gjithashtu duhet të jeni bashkëpunëtor i mirë i Bordit dhe Menaxhmentit.

Unë jam shumë i sigurtë se ju keni provuar që i posedoni të gjitha këto, andaj ju uroj sukses dhe fat në kryerjen e profesionit të aktuarit, një nga profesionet më të pëlqyeshme dhe të dëshiruara në botë.

Dhe për fund, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, si institucion përgjegjës për licencimin e aktuarëve, edhe në të ardhmen, do të përkrah iniciativa të tilla dhe do të inkurajojë personat me kualifikime të duhura për të marrë pjesë në programe të tilla, me qëllim të rritjes së numrit të profesionistëve të tillë në Kosovë.

Faleminderit dhe urime!